



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.5/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, duke vepruar sipas kërkesës së E [REDACTED] Sh [REDACTED] nga Gjilani, të cilën përfaqëson A [REDACTED] Sh [REDACTED] nga Gjilani, për iniciimin e procedurës disiplinore konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtarit B [REDACTED] S [REDACTED] -gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilani, për shkak të shkeljeve disiplinore, me datë, 29.09.2023, morri këtë:

AKTVENDIM

REFUZOHEN si të pabazuara kërkesat e E [REDACTED] Sh [REDACTED] nga Gjilani, të datës 14.09.2023 dhe 18.09.2023, për iniciimin e procedurës disiplinore, të paraqitur ndaj gjyqtarit B [REDACTED] S [REDACTED] - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilani.

ARSYETIM

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, datë 15.09.2023, ka deleguar kërkesën e ankueses E [REDACTED] Sh [REDACTED] nga Gjilani, pranë Autoritetit kompetent – Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilani, me të cilën ankuesja ka kërkuar shqiptimin e sanksionit disiplinor gjyqtarit B [REDACTED] S [REDACTED], me pretendimin se në lëndën C.nr. 809/2016, ka urdhëruar paditësen që të paguaj shumën prej 100 €, për siç i është referuar paditësja aktivitetin kriminal të gjeodetit, taksën për përjashtimin e gjyqtarit B [REDACTED] S [REDACTED] si dhe pagesën e shumës prej 30 €, për paraqitjen e një ankese, ashtu që tendenca e gjyqtarit B [REDACTED] S [REDACTED], që ta detyroj paditësen të paguaj për një ankesë e cila ishte ushtruar kundër veprimeve procedurale dhe vendimeve arbitrare, është plotësisht e kundërligjshme dhe paraqet precedent të rrezikshëm, taktikë për presion dhe tendencë për ta

rënduar gjendjen e vështirë financiare të paditëses. Ankuesja, pretendon se gjyqtari në fjalë, përmes Aktgjykimit në lëndën C.nr. 809/16 ka tentuar të nxisë konflikte dhe gjakderdhje në mes saj dhe të paditurit dhe mundet përsëri të planifikoj taktika dhe strategji për pengim të drejtësisë. Me datë 18.09.2023, në Gjykatën Themelore në Gjiilan, është pranuar një parashtrësë urgjente, me të cilën ankuesja i është drejtuar Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjiilan, lidhur me veprimet procedurale të gjyqtarit B. S. në lëndën me shenjën C.nr. 1923/2021, duke pretenduar se lidhur me parashtrësën e datës 07.09.2023, përmes të cilës ai kërkon pagesën e një takse gjyqësore prej 30 euro për një ankesë, me datë 13.09.2023, iu kanë drejtuar gjyqtarit B. S., për të kërkuar informacione në lidhje me ligjshmërinë dhe arsyeshmërinë e një pagese të tillë, por që meqenëse deri me datë 18.09.2023, nuk kanë pranuar ndonjë informacion lidhur me parashtrësat e përmendura, i janë drejtuar Kryetarit të kësaj gjykate, për të marrë informacion nëse pagesa e kërkuar nga gjyqtari B. S. është e bazuar në ndonjë dispozitë ligjore apo udhëzim administrativ.

Kryetari i gjykatës, pas analizimit të pretendimeve të palës ankuese, , ka gjetur se e kërkesat e E. Sh. janë të pabazuara.

Deri tek një përfundim i tillë Kryetari i gjykatës erdhi duke u bazuar në pretendimet e palës ankuese, si dhe analizimit të shkresave të lëndës, me ç'rast ka gjetur se kërkesa e ankueses tani e disa herë është trajtuar nga Gjykata Themelore në Gjiilan dhe atë mbi baza pothuajse të njëjta ankimore me pretendime të pa mbështetura në asnjë provë, ashtu që çështja kontestimore të cilës i referohet ankuesja e cila në procedurën e rigjykimit mban shifrën C.nr.1923/21, e në të cilën lëndë gjyqtari i çështjes Berat Spahiu kishte kërkuar nga kryetari i gjykatës që të përjashtohet, por që një kërkesë e tillë ishte refuzuar dhe se i njëjti bazuar në shkresat e lëndës ka vepruar konform kompetencave të tij si gjyqtar i çështjes.

Përfundimisht, kryetari i gjykatës ka gjetur se nuk është përmbushur asnjëra nga pikat e parapara në nenin 5 paragrafi të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Prokurorë dhe Gjyqtar, andaj konform nenit 9 paragrafi 6 të po të njëjtit ligj pasi që ka gjetur se ankesa është dukshëm joserioze dhe e pabazuar, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i gjykatës,

Venhar Salihu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet t'i dorëzohet:

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. Gjyqtarit të çështjes,
3. KGJK-së,
4. Dosjës së lëndës.